



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 130 /2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Muhamet Rexha anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër menaxherit të Qendrës së Votimit, Gani Neziri, për shkak të parregullsive gjatë procesit të votimit, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Ferizajt, në seancën e panelit të mbajtur me 03.05.2012, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN).

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 30.04.2012, nga Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN), me të cilën pretendohet se më datë 29.04.2012 në Qendrën e Votimit (QV) 2505D në shkollën “Konstantin Kristoforidhi” në fshatin Nerodime të Ferizajt, në zgjedhjet për Kryetar të Komunës së Ferizajt, që nga ora 12:00 e deri në mbylljen e kësaj qendre të votimit sipas parashtruesit të ankesës kishte grupe të organizuara të personave të paautorizuar, të cilët në një mënyrë ose në tjetrën influencohen në votues për të votuar partinë e tyre.

Parashtruesi i ankesës potencon se në këtë qendër të votimit, disa nga personat të cilët qëndronin në korridor dhe jashtë ndërtesës (në hyrje të ndërtesës), sipas ankuesit nuk ishin të pajisur me shenja dalluese të akreditimit. Ankuesi thekson se kishte edhe persona të cilët qëndronin gjatë gjithë kohës në korridor dhe ishin të pajisur me shenja dalluese të akreditimit, por të cilët bashkëvepronin me persona pa shenja dalluese të akreditimit. Këto grupe i drejtonin qytetarët të cilit vinin për të votuar se në cilën klasë duhej të votonin, duke u treguar se për cilën parti duhej të votonin ata. Parashtruesi i ankesës pretendon se menaxheri i kësaj qendre Gani Neziri, gjatë gjithë kohës sa ishte e hapur kjo qendër nuk ka ndërrmarë as edhe një herë një veprim për largimin e këtyre personave nga korridori dhe pjesa e jashtme e ndërtesës. Përkundrazi është parë shumë shpesh të qëndronte me këto grupe, siç thekson ankuesi.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Me ankesë e pretendohet se në QV 2505D, në fshatin Nerodime në ditën e votimit për kryetar të Komunës së Ferizajt kanë hyrë grupe të organizuara të personave të paautorizuar që nuk ishin të pajisur me shenja dalluese të akreditimit dhe nga pretendimet e ankuesit, menaxheri i kësaj qendre Gani Neziri nuk merrte veprim për largimin e këtyre personave nga korridori dhe pjesa e jashtme e ndërtesës. PZAP-i gjeti se pretendimet e tilla ankimore nuk qëndrojnë për faktin se në ankesë nuk janë dhënë prova dhe dëshmi të cilat eventualisht do ti argumentonin pretendimet e tilla ankimore, andaj duke marr parasysh këtë, në kuptim të nenit 115.1 lidhur me 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

A nr. 130/2012 më datën 03.05.2012.

Kryesuesi i Panelit
Muharrem Shala

